

Raport
i Vlerësimit të Jashtëm
për
programin e ciklit të dytë të studimit
Master Profesional në “Sociologji
Zhvillimi” me profil “Zhvillim Social
Komunitar”
në SHLUP “Universiteti Marin Barleti”

Eksperti i vlerësimit të jashtëm: Dr. Eliona Kulluri Bimbashi

Korrik 2015

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit MP në “Sociologji zhvillimi”

me profil “Zhvillim social komunitar”

HYRJE

Programi “*Master Profesional në Sociologji Zhvillimi me profil Zhvillim Social Komunitar*” është hapur në bazë të Urdhërit nr.335 datë 07.11.2012 të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, pranë Departamentit të Shkencave Sociale dhe Edukimit, Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike, SHLUJ UMB. Programi është zhvilluar në një cikël të vetëm, në harkun kohor Nëntor 2012 – Mars 2014 dhe aktual. Në këtë program janë rregjistruar dhe kanë ndjekur programin 8 studentë. Aktiviteti mësimor është zhvilluar në bazë të planit mësimor në 10 lëndë duke përfshirë edhe Praktikën profesionale dhe Tezën finale. Aktiviteti mësimor (leksione dhe seminare) është zhvilluar sipas një orari të planifikuar në dy ditë të javës, të Premte dhe të Shtunë, duke angazhuar 5 pedagogë.

Programi synon formimin akademik të specialistëve të sociologjisë, për t’iu përgjigjur kërkesave të zhvillimit social të shoqërisë shqiptare, në kontekstin e zhvillimeve bashkëkohore evropiane e globale, si dhe përgatitjen specialistë me koncepte dhe aftësi teorike e metodologjike për studimin – me këndvështrimin dhe metodat konkrete të sociologjisë bashkëkohore – të problemeve të zhvillimit social komunitar.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

1. Dr. Eliona Kulluri Bimbashi

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Programi “*Master Profesional në Sociologji Zhvillimi me profil Zhvillim Social Komunitar*” përputhet me strategjinë e zhvillimit të institucionit pasi ai është konceptuar në përputhje me vizionin për të plotësuar misionin dhe objektivat strategjike të tij gjë që vihet re në faktin që programi master është ndërtuar mbi programin bachelor në sociologji si dhe plotëson synimin për të përgatitur specialistë në fushën e sociologjisë komunitare, një fushë me perspektivë për tregun e punës, përipiqet të kombinojë njohuritë akademike me praktikën, mësimin me kërkimin, me një vëmendje edhe në përvojat ndërkombëtare.

Qëllimet dhe objektivat e programit për të ofruar një formim teorik të specializuar në fushën e sociologjisë së zhvillimit, kompetenca të sociologut në zhvillimin e komunitetit dhe aftësimin e studentëve në kërkimin shkencor në sociologjisë së zhvillimit social komunitar janë të reflektuara në programin mësimor në përgjithësi dhe në lëndë specifike dhe përipiqen t’iu përgjigjen zhvillimeve sociale në përgjithësi në vend me një theks të vecantë tek njohja e dinamikave aktuale sociale në nivel komunitar.

Programi “*Master Profesional në Sociologji Zhvillimi me profil Zhvillim Social Komunitar*” përputhet me strategjinë e zhvillimit të institucionit pasi ai është konceptuar në përputhje me vizionin për të plotësuar misionin dhe objektivat strategjike për disa arsye: është ndërtuar mbi programin bachelor në sociologji, synon të përgatisë specialistë në fushën e sociologjisë, për tregun e punës, është konceptuar si një model që kombinon

standardet akademike me aplikimet e botës reale, kombinon përgatitjen teorike, kërkimin shkencor dhe eksperiencat praktike në vend, duke integruar edhe dimensionin ndërkombëtar.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;	Programi i studimit “Master Profesional në Sociologji Zhvillimi me profil Zhvillim Social Komunitar” është përgjithësisht në përputhje me misionin dhe qëllimet e institucionit, duke qenë se ka si mision të përgatisë specialistë të sociologjisë, me koncepte dhe aftësi teorike e metodologjike bashkëkohore, të problemeve të zhvillimit social komunitar, për studimin e problemeve sociale, të nevojave të tregut, etj.
Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	SHLUJ UMB raporton se ka bërë një studim të tregut nëpërmjet anketimit, i cili ka arritur në përfundimin se zhvillimi social komunitar është një program i kërkuar si nga sociologët e diplomuar tashmë ashtu dhe ata që synojnë të punojnë në sektorin e zhvillimit të komunitetit, si një sektor me perspektivë.
Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;	Në pjesën më të madhe të programeve/syllabus-eve dhe vecanërisht “Probleme sociale bashkëkohore” apo “Demokracia pjesëmarrëse” trajtohen/analizohen në vecanti tema dhe problematika të ndjeshme shoqërore që lidhen e reflektojnë zhvillimin aktual socio-ekonomik të vendit.
Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	Në program ky aspekt është realizuar përmes përfshirjes në programin e lëndëve të temave dhe rasteve që trajtojnë vlerat dhe praktikatat pozitive të zhvillimit social në Shqipëri.
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;	Programi “Master Profesional në Sociologji Zhvillimi me profil Zhvillim Social Komunitar” në përpjekjen për tu përshtatur me strategjinë për zhvillimin e institucionit, ka përcaktuar objektiva që përputhen me strategjinë e zhvillimit të institucionit, ato duken të jenë qarta dhe të matshme. Këto objektiva përputhen në faktin që programi është ndërtuar bazuar në programet bachelor që ofrohen, sidomos ai i sociologjisë, është konceptuar si një model që kombinon standardet akademike me modelet praktike, duke integruar edhe dimensionin ndërkombëtar.
Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
Kriteri 1 Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;	Programi “Master Profesional në Sociologji Zhvillimi me profil Zhvillim Social Komunitar” është ndërtuar mbi bazën e kriterëve të përcaktuara nga Ligji për Arsmin e Lartë, nga Udhëzimet e MAS dhe të APAAL.
Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.	Programi “Master Profesional në Sociologji Zhvillimi me profil Zhvillim Social Komunitar” i përket nivelit 7 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimit.
Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.	
Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;	SHLUJ UMB ka një plan të zhvillimit strategjik të IAL dhe ka parashikuar politikën e zhvillimit të programeve të studimeve master, ku zhvillimi i një programi të tillë është një nga drejtimet e përcaktuara.

<p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Zhvillimi i këtij programit është një mundësi më shumë për të përmirësuar procesin e mësimdhënies dhe të nxënit, pasi sipas pedagogëve dhe studentëve janë kombinuar metoda të avancuara dhe interaktive të mësimdhënies/nxënies, si puna e pavaruar dhe pjesëmarrja në praktikë mësimore dhe aktivitete shkencore të organizuara nga institucioni si konferencat shkencore, etj.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p>	
<p>Bazuar në dokumentacion që zotëron SHLUJ UMB, rezulton se institucioni ka një plan të zhvillimit strategjik, ka përcaktuar dhe artikuluar qartë vizionin dhe misionin, të reflektuara edhe në dokumentin e Planit të Zhvillimit Strategjik. Njëkohësisht misioni i “Masterit Profesional në Sociologji Zhvillimi me profil Zhvillim Social Komunitar” është i shprehur qartë në Rregulloren e Studimeve të këtij programi. Misioni i institucionit synon të kombinojë ofertën akademike, kërkimin shkencor të aplikuar, përvojën aktive të studentëve, shërbime me vështrim ndaj sociologjisë së zhvillimit, si një nga drejtimet prioritare të studimeve dhe zhvillimeve sociologjike të aplikuara në vend.</p>	
<p><i>Standartet e paraqitura më lart janë përmbushur.</i></p>	

2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike synon të përgatisë profesionistë në fushat si drejtësia, shkencat sociale, politike dhe edukimit. Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike përbëhet nga tre departamente: Departamenti i Drejtësisë, Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit, dhe Departamenti i Shkencave Politike dhe 2 institute, Instituti Shqiptar i Cështjeve Publike dhe Instituti i Edukimit “Barleti”.

Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit: Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit përbëhet nga tre njësi didaktike: njësia e Sociologjisë, njësia e Psikologjisë dhe njësia e Edukimit. Departamenti realizon programe studimi në nivelin bachelor, në Sociologji, Psikologji dhe **Edukim Fizik e Sporte**.

Stafi akademik i këtij departamenti me kohë të plotë dhe te pjesshme përbëhet nga lektorë me tituj dhe grada, konkretisht: 1 profesor, 3 profesor të asociuar, 7 doktor dhe 7 me MSc., një pjesë e të cilëve janë në proces doktorature.

Këshilli i Fakultetit është organ kolegjal vendimmarrës i Fakultetit. Ai merr në shqyrtim dhe vendos për problemet më të rëndësishme të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe kualifikimit.

Këshilli i Fakultetit përbëhet nga 7 anëtarë, të cilët zgjidhen nga personeli akademik i Fakultetit. Mandati i anëtarëve të Këshillit të Fakultetit është tre vjet. Anëtarët e Këshillit të Fakultetit përfaqësojnë personelin akademik të Fakultetit. Ata mund të jenë gjithashtu personel akademik i ftuar ose bashkëpunëtorë shkencorë të jashtëm. Si rregull, në Këshillin e Fakultetit janë të përfaqësuar të gjitha departamentet dhe njësitë kërkimore-shkencore të Fakultetit. Anëtari zgjidhet me votim të anëtarëve të personelit të njësisë që ai përfaqëson.

Përbërja e Këshillit të Fakultetit

Nr	Emri mbiemri	Titulli/grada	Pozicioni në Këshill
1	Luan Omari	Akademik	Kryetar
2	Zamira Çavo	Prof.As.Dr.	Anëtar
3	Saemira Pino	Dr.	Anëtar
4	Robert Gjedia	Dr	Anëtar

5	Lluka Heqimi	Prof.Dr.	Anëtar
6	Ilir Panda	Dr.	Anëtar
7	Dorian Jano	Dr.	Anëtar

Dekani është anëtar dhe Kryetar i Këshillit të Fakultetit për shkak të detyrës dhe e përfaqëson atë në marrëdhëniet me Senatin.

Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinator/ët e programit të studimit:

Emër Mbiemër	Titulli/grada	Pozicioni në Këshillin shkencor
Saemira Gjipali	Dr.	Kryetare
Robert Gjedia	Dr.	Koordinator
Migena Kapllanaj	Dokt.	Anëtare

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;	Institucioni bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi është organizuar në 2 Fakultete dhe njësitë përkatëse për të përmbushur misionin e tij.
Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;	Institucionit në përputhje me Nenin 102 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe pikave 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 9741, dat 21.05.2007 “Për arsimin e Lartë në RSH”, të ndryshuar, me urdhër Ministri i është aprovuar riorganizimi në 2 njësi kryesore, Fakultetit i Drejtësisë, Shkencave Sociale dhe Politike dhe ai i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë me përkatësisht 5 dhe 4 njësi bazë.
Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;	Fakulteti i Drejtësisë, Shkencave Sociale dhe Politike përbehet nga 5 njësi, 3 departamente dhe 2 institute: <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Drejtësisë • Dep. Shkencave Sociale • Dep. I Shkencave Politike • Instituti Shqiptar i Cështjeve Publike • Instituti I Edukimit “Barleti”
Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;	
Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.	Departamenti i Shkencave Sociale dhe të Edukimit përbëhet nga 10 anëtarë efektivë, ndër të cilët 5 janë me tituj e grada, 1 profesor dhe 4 doktorë.
Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;	Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit është përgjegjës për ofrimin e programeve të studimit në nivelet Bachelor dhe Master Shkencor si dhe Profesional. Nga dy profilet e programit master profesional në Sociologji zhvillimi me profil “Zhvillim ekonomik e studim tregu” dhe ai i “Zhvillimit komunitar”, të planifikuar të hapen nga ky departament, është hapur vetëm ky i dyti.
Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.	

	Departamenti ka qenë përgjegjës për përzgjedhjen dhe rekrutimet e personelit akademik, duke u bazuar në kriteret e përgjithshme të punësimit të stafit të UMB, si dhe specifikimin e kriterëve të fushave të ekspertizes për mësimdhënien e lëndëve specifike, sidomos për personelin me kohë të pjesshme.
--	--

Konkluzionet e vlerësimit:

Departamenti i Shkencave Sociale dhe të Edukimit, është një nga 5 njësitë e Fakultetit të Drejtësisë, Shkencave Sociale dhe Politike. Ai është përgjegjës për ofrimin e programit Master Profesional në Sociologji Zhvillimi me dy profile, njëri prej të cilëve “Zhvillimi Komunitar”, i cili ka përfunduar ciklin e plotë të mësimit në auditor, praktikën dhe pjesërisht fazën e diplomimit. Ai ka mundur gjithashtu të përcaktojë kriteret e përzgjedhjes së personelit akademik bazuar në fushat e ekspertizes dhe interesit të pedagogëve.

Standartet janë arritur.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Personeli akademik dhe mbështetës

Stafi administrativ është i organizuar në nivel institucioni në dy struktura: për programet bachelor dhe për programet master.

Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë: PAE, PAK, PA, tituj/gradat.

	Departamenti i Drejtësisë							
	Numri i PAE		Numri i PAK		Numri i PA		Në Total	
	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada
Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale e Politike	4	Dr	4	Dr	-	-	8	Dr
	5	MSc	4	MSc	-	-	9	MSc
	-	Prof. Asoc Dr	-	Prof. Asoc Dr	-	-	-	Prof.Asoc. Dr
	1	Prof. Dr	-	Prof.Dr	-	-	1	Prof.Dr
	Departamenti i Shkencave Politike							
	1	Prof.As. dr	3	Prof.Dr	-	-	3	Prof.Dr
	2	Dr	1	Dr	-	-	4	Dr
	4	Msc	2	Msc	-	-	6	MSc
	-	-	1	Prof.Asoc Dr	-	-	1	Prof.Asoc Dr
	Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit							
	4	Dr	1	Dr	-	-	1	Dr
	5	MSc	6	MSc	-	-	13	Msc
	-	Prof. Asoc Dr	1	Prof. Asoc Dr.	-	-	2	Prof.ASoc Dr
	1	Prof. Dr	-	Prof.Dr	-	-	1	Prof.Dr

Cilësia e stafit drejtues, mësimdhënës dhe administrativ për çdo njësi:

Departamenti i Drejtësisë							
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time
1	Ilir Panda	Përgjegjëse dep.	Dr	1	Jordan Daci	Dr	Ministria e Financës
2	Luan Omari	anëtar	Akademik	2	Edlira Baraj	Dr	UT
3	Ledian Dobroniku	anëtar	Dr	3	Juliana Latifi	Dr	Këshilltare në parlament
4	Enkelejda Pulaj	anëtar	Dr	4	Ilir kalemi	Dr	Universiteti i Neë Yorkut
5	Mirea Selita	anëtar	Dr	5	Lulzim Alushaj	Msc	Avokat i lirë
6	Esmeralda Hasani	anëtar	MSc	6	Engjell Hysi	MA	Ministria e Drejtësisë
7	Jonida Lamaj	anëtar	MSc/Doktorante	7	Sander Simoni	MA	Gjykata e Krimeve të Rënda
8	Elona Bano	anëtar	MSc (Dokt)	8	Tildi Çadri	Msc	APAAL
9	Valbona Alikaj	anëtar	MSc (Dokt)				
10	Edlira Lloha	anëtar	LLM				
Departamenti i Shkencave Politike							
Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli/Grada	Institucioni ku punon full time
1	Zamira Çavo	Përgjegjëse dep.	Prof. Ass. Dr.	1	Paskal Milo	Prof. Dr.	Kërkues i lirë
2	Reis Mulita	anëtar	PhD	2	Eralda Methasani	Prof. Asoc. Dr.	Këshilltare e Kryeministrit
3	Dorian Jano	anëtar	PhD	3	Shpëtim Cami	Dr.	Kryetar i Njësisë Bashkiake 1 Tiranë

4	Ervis Martani	anëtar	PhD	4	Petrit Dollani	Dr.	UT
5	Eurona Leka	anëtar	MSc (Dokt)	5	Ilia Kristo	Prof. Dr.	UT
6	Erijon Kristo	anëtar	MSc (Dokt)	6	Lavdosh Ahmetaj	Dr.	Universiteti i Durrësit
7	Fatjona Qurku	anëtar	MSc	7	Gjergji Dhima	MSc	Biznes privat
8	Xhuljeta Krasta		MSc (Dokt)				

Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit

Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli /Grada	Personeli Akademik me Kontratë (Emër Mbiemër)		Titulli /Grada	Institucioni ku punon full time
1	Gëzim Hadaj	Përgjegjës dep.	Prof. Dr.	1	Marjana Çadri	Dr.	Ministria e Mbrojtjes
2	Edita Fino	anëtare	Dr.	2	Stavri Trako	Dr.	Pension
3	Saemira Pino	anëtare	Dr.	3	Erlira Koçi	Prof. Asoc. Dr.	Pension
4	Silvana Loka	anëtare	Msc. (Dokt)	4	Bashkim Peçi	Prof. Asoc. Dr.	Kërkues i lirë
5	Enkelejda Hamzaj	anëtare	MSC (Dokt)	5	Nazim Shtino	Msc	Pension
6	Migena Kapllanaj	anëtare	MSC (Dokt)	6	Lekë Sokoli	Prof. Asoc. Dr.	Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës
7	Aida Hudhri	anëtare	MSc	7	Florian Kulla	Msc. (Dokt)	OJF,
8	Sokol Jareci	anëtar	MSc	8	Stavri Sinjari	Dr.	Kërkues i lirë
9	Alketa Caushaj	anëtare	Dr.				
10	Robert Gjedia	anëtar	Dr.				

Të dhënat sipas kualifikimit dhe raportet midis tyre:

Titulli	Departamenti i Drejtësisë			Departamenti i Shkencave Politike			Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit		
	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK
Profesorë	1	0	1/0	0	2	0/2	1	0	1/0
Profesorë të As.	0	0	0/0	1	1	1/1	1	3	1/3
Doktorë	4	4	4/4/	3	3	3/3	4	3	4/3
Pedagogë (pa tituj)	5	4	5/4/	4	1	4/1	5	0	5/0
Asistentë me MSc									
Asistentë pa MSc									
Personeli Administrativ ¹									

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Institucioni realizon përzgjedhjen në punë të personelit me kohë të plotë dhe personelit me kohë të pjesshme bazuar në kriteret e paracaktuar.</p> <p>Personeli i angazhuar në Programin “Master Profesional në Sociologji Zhvillimi me profil Zhvillim Social Komunitar” zhvillojnë aktivitetin e tyre bazuar në detyrat e parashikuara në kontratën e punës apo të shërbimit. Ka pasur ndryshime në raportin pedagog i bredshëm / të jashtëm (në 10 pedagogë të sociologjisë janë larguar 2, të cilët vazhdojnë angazhimin me kohë të pjesshme.)</p>
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli i Fakultetit të Drejtësisë, Shkencave Sociale dhe Politike dhe i departamentit në vecanti është përfshirë pjesërisht në hartimin e kurrikulës së programit, vecanërisht ai me kohë të plotë dhe më me eksperiencë. Në 6 lëndët e programit vetëm dy prej syllabus-eve janë hartuar nga një ënëtar i personelit efektiv (me kohë të plotë) të Fakultetit, kurse 4 të tjerat nga personel me kontratë. Koordinator i programit është personel efektiv i departamentit.</p>

¹ Funksionon në nivel shkolle

	<p>Rekrutimit i stafit akademik bëhet sipas kritereve dhe proceduarve të miratuara nga Senati. Pas thirrjes për aplikim dhe dorëzimit të dokumentacionit pranë Zyrës së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ose Sekretarisë së Universitetit, Komisioni i përzgjedhjes dhe Intervistimit bën përzgjedhjen e kandidatëve që plotësojnë kushtet e konkurrimit dhe i ftojnë ata në një proces intervistimi me 2 faza.</p> <p>Në kriteret kryesore përfshihet nota mesatare mbi 8, grada Dr. por në mungesë aplikimesh apo për nevojave specifike të fushave të studimit rekrutohen edhe kandidatë me MSc. dhe CV të përshtatshme.</p>
<p>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Dosjet e aplikantëve janë të pajisura me dokumente shoqëruese, si CV, diploma të studimeve e lista të notave, botime e dëshmi të gjuhëve të huaja. Në dosjet te personelit me kohë të pjeshme, ka raste që mungon deklarata nga punëdhënësit.</p> <p>Në Programin “Master Profesional në Sociologji Zhvillimi me profil Zhvillim Social Komunitar” 4 lëndë janë mbuluar nga pedagogë të brendshëm dhe 2 lëndë nga pedagogë të jashtëm. Personeli i brendshëm përbën rreth 60% të personelit akademik.</p> <p>Në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore e UMB janë të depozituara (dosje personale aplikimi dhe punësimi, tabela statistikore) për të gjithë personeli, kontrata individuale të punës për personelin me kohë të plotë dhe atë me kohë të pjeshme.</p>
<p>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</p>	
<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të</p>	<p>Koordinatori i programit ka gradën MSc. Dhe është në proces doktorature.</p> <p>Kriteri 2 nuk aplikohet për këtë program.</p> <p>Në Programin “Master Profesional në Sociologji Zhvillimi me profil Zhvillim Social Komunitar” japin mësim 4 pedagogë me gradën shkencore “Doktor” dhe 1 pedagog me gradën “Master i Shkencave” me eksperiencë mbi 5 vjet në punë.</p> <p>Sipas të dhënave dhe tabelave në dispozicion nga institucioni autoritetet/personat drejtues të UMB si dhe ata përgjegjës për zhvillimin e programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucion prej disa vitesh.</p> <p>Në këtë program udhëheqja dhe mbikëqyrja e praktikave është e mundur të realizohet nga pedagogët e programit, për vetë faktin që numri i studentëve (8) është i më vogël se sa personeli mësimdhënës. Koordinatorin e programit ka dhe përgjegjësinë për të koordinuar këto komponentë të procesit mësimor.</p>

<p>plotë në institucionin që ofron programin e studimeve; Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	
<p>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli; Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”; Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Pjesa më e madhe e studentëve janë ende në fazën e punimet të diplomës. Vetëm tre studentë kanë përfunduar procesin e mbrojtjes së diplomës edhe pse akoma nuk janë diplomuar zyrtarisht.</p> <p>Në dy raste është caktuar si bashkëudhëheqëse një pedagoge me MSH dhe si udhëheqës një pedagog me MSH por me një përvojë të gjatë në fushë.</p> <p>Në Programin “Master Profesional në Sociologji Zhvillimi me profil Zhvillim Social Komunitar”, udhëheqësit shkencorë mbikëqyrin 1-2 studentë të programit.</p>
<p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit. Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Duke qenë se pedagogët udhëheqës janë njëkohësisht ekspertë të studimeve sociale dhe temat janë të fokusuar kryesisht në çështje të zhvillimit social dhe komunitar nuk konstatohen mospërputhje në këtë drejtim. Studentët raportojnë zhvillimin e konsultimeve të vazhdueshme me udhëheqësin.</p> <p>Sipas listës së udhëheqësve rezulton se ata janë të përshtatshëm për udhëheqjen e punimeve, CV e të cilëve po ashtu dëshmojnë njohuri teorike dhe aftësi kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në përputhje me tematikën e tezave.</p>
<p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore; Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Sekretari i departamentit dhe IT asistojnë pedagogët dhe studentët gjatë përdorimit të pajisjeve kompjuterike në laboratorin e informatikës sidomos në rastin e lëndës së Metodave Kërkimore, ku përdorimi i tyre është i nevojshëm.</p> <p>Diversiteti i pozicioneve të punës për shërbimet, mundësojnë angazhimin e tyre për të përmbushur objektivat e programit.</p>
<p>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi; Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë</p>	<p>Ngarkesa Mësimore në program realizohet nga personel efektive me kohë të plotë apo me kontratë me kohë të pjesshme.</p> <p>Ngarkesa mësimore e personelit është përcaktuar në orë mësimore sipas planit mësimor të Programit dhe reflektuar e detajuar edhe në syllabuset e lëndëve specifike.</p>

dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.	
Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Institucioni disponon të dhëna mbi personelin akademik të përfshirë në Programin “Master Profesional në Sociologji Zhvillimi me profil Zhvillim Social Komunitar” në dosjen personale për secilin, ku përfshihen të dhëna për ngarkesën mësimore, eksperiencat kërkimore shkencore apo praktike, botime dhe studime në 2 periodikët e institucionit apo të tjera jashtë tij.</p> <p>Institucioni dhe strukturat e veta disponojnë listën e plotë të personelit akademik që jep mësim në Programin “Master Profesional në Sociologji Zhvillimi me profil Zhvillim Social Komunitar”, si dhe kanë informacion mbi personelin e angazhuar në realizimin e programit dhe periudhën kohore të realizimit të detyrave përkatëse, përkatësisht 3 pedagogë të angazhuar në semestrin e parë dhe 2 në të dytin.</p> <p>Kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit publikohen on line dhe në mënyrë jo formale në rrjetet e pedagogëve dhe personelit.</p>
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>	
<p>Institucioni ka një politikë të paracaktuar për rekrutimin e personelit efektiv dhe atë me kontratë, që bazohet në kriteret dhe procedura të mirëpërcaktuar dhe miratuara nga Senati. Zyra e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për menaxhimin e gjith procesit të rekrutimit, dhe disponon dokumentacion të plotë për aplikantët (dosje personale dhe dokumentacion mbështetës). Zbatimi i kritereve garantojnë cilësinë e rekrutimit të personelit.</p> <p>Personeli akademik është i përfshirë dhe luan rol në hartimin e kurrikulës, në vendimet institucionale që lidhen me organizimin e programit të studimit, procesin e vlerësimit të brendshëm dhe të përmirësimit të cilësisë. Personeli i përfshirë në program ka qenë kryesisht me kontratë me kohë të plotë (60%).</p> <p>SHLUJ UMB ka respektuar standardin dhe cilësinë e personelit të angazhuar në programin “Master Profesional në Sociologji Zhvillimi me profil Zhvillim Social Komunitar” duke angazhuar në procesin mësimdhënës 5 pedagogë me gradën Dr. dhe vetëm një me MSc dhe eksperiencë të punë mbi 5 vjet.</p> <p><i>Standardet e personelit akademik janë përmbushur pjesërisht.</i></p>	

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

SHLUJ UMB disponon dy kampuse, i pari i destinuar për studimet bachelor dhe administratën, ndërsa i dyti për studimet master. Mjediset janë të përshtatura për salla leksionesh, laboratorë, zyra, hapësira parkimi, mjedise çlodhëse. Pajisje të fotokopjeve dhe kompjuterave, mensa, biblioteka, Zyra e rekrutimit, Zyra e Këshillimit, Klinika e Këshillimit psiko-social, Mentorët e Grupeve, Dekani i Studentëve janë në dispozicion të studentëve.

Tregues të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit

- Salla për leksione (25)
- Klasa për seminare
- Salla për aktivitete promovuese (2)
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale
- Laboratorë për lëndët
- Laboratorë informatike (4)
- Salla interneti (2)
- Salla për bibliotekë (2)
- Mjedis për fotokopjime, librari, etj. (2)
- Zyra informacioni për studentët (4)
- Nyje hidrosanitare (9)

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin (5)
- Zyra për sekretarinë mësimore (2)
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore (3)
- Zyra për personelin akademik (sipërfaqe 758 m2)

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Institucioni ka dy kampuse me vendndodhje të përhershme në zonën pranë kodrave të Liqenit me mjedise të përshtatura për zhvillimin e aktiviteteve mësimore, kërkimore, administrative dhe të shërbimit.</p> <p>Mjediset janë pronë e aksionarëve të SHLUJ UMB.</p> <p>Procesi mësimor dhe aktivitetet e lidhura me të si dhe shërbimet për studentët zhvillohen në dy godina. Në të parën (kampusin 1) ndodhen zyrat e Departamentit të Shkencave Sociale dhe Edukimit, biblioteka dhe sallat ku zhvillohen programet e nivelit të parë të studimeve bachelor, ndërsa në tjetrën (kampusin 2) ndodhen sallat e mësimimit për programet master, laboratorit i kompjuterave, sekretaria mësimore dhe shërbimet ndihmëse. Stafit raporton se nuk kanë asnjë problem për koordinimin dhe menaxhimin e veprimtarisë.</p> <p>Kriteri 4 nuk aplikohet për këtë program</p>
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p>	<p>Institucioni ka botuar një pjesë të teksteve mësimore dhe literaturës ndihmëse për programin. Nga hulumtimi i 6 syllabus-eve dhe bibliografisë respektive, rezulton të jenë listuar në literaturën bazë apo atë ndihmëse rreth 8 tituj të autorëve shqiptarë dhe përkthime të autorëve të huaj nga Shtëpia Botuese Dudaj.</p>

<p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Biblioteka disponon literaturë në gjuhë shqipe dhe të huaj për Programin “Master Profesional në Sociologji Zhvillimi me profil Zhvillim Social Komunitar”.</p> <p>Institucioni në bashkëpunim me Institutin e Sociologjisë boton revistën “Gjeopolitika” (gjithsej botuar 9 numra) dhe ofron vëllimet periodike të revistës shkencore “Social Studies”, e cila është një burim për studentët e programit “Master Profesional në Sociologji Zhvillimi me profil Zhvillim Social Komunitar”.</p> <p>Personeli referon se ka nevojë për akses në literaturë/periodikë elektronikë. Në këtë kuadër Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit ka hartuar një listë me tituj të revistave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët.</p> <p>Oraret e shërbimit të bibliotekës janë të shpallura në hyrje të saj si dhe në internet.</p>
--	--

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.

<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>Institucioni disponon një numër të mjaftueshëm sallash me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit kryesisht për prezantime, dy laboratorë me PC për studentët si dhe pajisjet e nevojshme për stafin akademik dhe stafin ndihmës.</p> <p>Në sallat e seminareve, të cilat kanë përmasa më të vogla se ato të leksioneve, vendosja e tavolinave është e tillë që lejon mobilitetin dhe përshtatjen me metodat e mësimdhënies dhe procesin mësimor në grupe të vogla pune.</p> <p>Laboratori i informatikës i pajisur me kompjutera dhe programe të përpunimi të të dhënave, (SPSS, STATA) përdoret për zhvillimin e një pjese të seminareve në lëndën e Metodave Kërkimore.</p> <p>Programi “Master Profesional në Sociologji Zhvillimi me profil Zhvillim Social Komunitar” nuk parashikon praktika laboratorike, përveç përdorimit të laboratorit të infomatikës sic është shpjeguar më lart</p>
--	---

Konkluzionet e vlerësimit:

Mjediset fizike edhe pse të ndara në dy kampuse të veçanta, janë të bollshme, të larmishme në raport me funksionin dhe shërbimet për personelin e studentët. Mjediset janë të pajisura me pajisje në funksion të realizimit të procesit mësimor. Sallat e vogla të seminareve janë të mobiluara në mënyrë të tillë që krijojnë mundësinë e dhe fleksibilitetin e përdorimit të metodave interaktive të mësimdhënies. Laboratori i informatikës (kompjutera + programe kompjuterike SPSS) rezulton të jetë i efekshëm në zhvillimin e seminareve të lëndës së Metodave të Aplikuara të Kërkimit.

Standartet të plotësuara.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

SHLUJ UMB është shoqëri tregtare, e cila arkëton të ardhura kundrejt shërbimeve të ofruara. Të ardhurat e saj janë kryesisht të siguruar nga tarifat e studimit që paguajnë studentët. Ofrohen dhe bursa për studentë ekselentë. Në institucion funksionojnë disa zyra/individë të ngarkuar për përmbushjen e detyrave financiare: Kancelari i Universitetit, Administratori, Përgjegjësi i Financës, Financieri. Shoqëria i nënshtrohet auditimit çdo vit nga ekspertë financiarë, si dhe kontrole të auditime të realizuara nga ekspertë të shoqërive të grupit “Dudaj” për llogaritë të aksionerëve të shoqërisë. Gjithashtu i është nënshtuar edhe kontrollit nga organe tatimore.

Të ardhurat nga:	Viti 2012	Viti 2013
Pushteti qendror		
Pushteti vendor		
Fonde jopublike:		
Grantet për kërkim dhe kontratat		
Konsulencat, shërbimet		
Tarifat për dhe gjatë shkollimit	107,562,540	99,385.000
Sponsorizimet		
Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)		
Donacionet, aktivitetet sigurose, fondacione etj		
Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)		
Të tjera (qera, ndryshime kursi valutor, interesa bankare)	170, 220	7,772.000
Gjithsej	107,562,760	17,157,000
<i>SHUMA</i>		

Shpenzime për vitin akademik 2013	Viti 2013
Paga e Sigurimeve	158.000.000
Shpenzime operacionale	3.590.000
Shpenzime kërkimi e zhvillimi	3.169.000
Shpenzime studentore	2.890.240
Shpenzime marketingu	3.215.000
Shpenzime infrastrukture dhe amortizime	11.886.000
Shuma	289,750,240

- Grantet për kërkim janë përfituar nga disa projekte, një prej të cilëve pritet të financohet së afërmi për projektin “Shkolla Komunitare” në bashkëpunim me MAS.
- Konsulencat, shërbimet
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit variojnë në një mesatare 2100 Euro në vit.
- Sponsorizimet
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm) janë realizuar në fushën e edukimit me mësues.
- Donacionet, aktivitetet sigurose, fondacione etj
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj). Institucioni disponon 2 bare përkatësisht të vendosura në 2 kampuset.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>Raporti i auditit të brendshëm përmban një pasqyrë të situatës financiare për përdorimin e të ardhurave të grumbulluara nga shërbimet që ofron institucioni në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p> <p>Raporti i auditit të brendshëm përmban një pasqyrë të granteve të huaja të përfituara në funksion të realizimit të programeve të studimeve dhe të eficiencës së përdorimit të buxhetit si përfituara dhe të kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p> <p>Raporti i auditit të brendshëm analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Zyra e Financës e SHLUJ UMB harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve master.</p> <p>Institucioni dëshmon se ka qëndrueshmëri financiare dhe kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen. Fakti që SHLUJ UMB është pjesë e Shoqërisë “Dudaj” garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit dhe programit.</p>
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>	
<p>Institucioni ka në strukturën e vet Zyrat e Administratorit dhe atë të Financës, që kanë përgjegjësinë për menaxhimin financiar. Po ashtu Kancelari është autoriteti që përgatit raportin e auditit të brendshëm për gjithë situatën financiare dhe përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë. Burimet kryesore të të ardhurave janë kapitali financiar i Shoqërisë ”Dudaj“ pjesë e të cilës është SHLUJ UMB, të ardhurat e siguruara nga tarifa e shkollimit që paguajnë studentët dhe grantet e projekteve. Pjesa më e madhe e burimeve financiare janë përdorur për burimet njerëzore, pra për personelin e brendshëm dhe të jashtëm duke i vënë një rëndësi të madhe nivelit të mësimdhënies dhe kërkimit në këtë institucion. Zëri i dytë i rëndësishëm në buxhet janë investimet për infrastrukturën, dhe i treti për shpenzime të parashikuara për veprimtaritë kërkimore dhe sociale.</p> <p>Institucioni dëshmon se ka qëndrueshmëri financiare dhe kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave.</p> <p><i>Standardet e aspektit financiar janë plotësuar.</i></p>	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Institucioni ka krijuar Njësinë e Vlerësimit të brendshëm i cili ndihmon për vlerësuar përmbushjen e standardeve të cilësisë, dhe realizimin e një reflektimi kolektiv institucional për të përmirësuar cilësinë. Procesi i vlerësimit të brendshëm përfshin mbledhjen sistematike të të dhënave administrative, anketimin e studentëve dhe të diplomuarve, intervistimin e pedagogeve dhe të studentëve. Ky proces përmbyllet me një raport që analizon statusin e institucionit ose/dhe të programit të studimit përkundrejt standardeve shtetërore të cilësisë.

Për sigurimin e përbërë nga dy Seksione: seksioni që përgjigjet për cilësinë e programeve bachelor dhe ai që përgjigjet për cilësinë e programeve master.

Tregues të matshëm:

- Të dhëna për anëtarët e NJSBC

	Anëtarët e NJSBC	Detyra që ka në NJSBC	Sa kohë ka në këtë detyrë
1	Semiha Loca, Prof. Asoc. Dr.	Specialiste, Studimet bachelor	2009
2	Robert Gjedia, Dr	Specialist, Studimet master	2014
3	Migena Kapllanaj, Doktorante	Specialiste, Studimet master	2010

- Të gjithë pytesorët përpunohen dhe rezultate i paraqiten me shkrim Rektorit. Rezultatet e tyre bëhen pjesë e diskutimeve në Senat. Gjithashtu rezultatet u komunikohen pedagogëve individualisht. Studentët njoftohen për rezultate e vlerësimeve të tyre për çështje të përmirësimit të kurrikulave dhe të mësimdhënies.
- Bazuar në këto vlerësime janë bërë ndryshime në kurrikula, përmirësime të niveleve të shërbimit, mbyllje kontratash me staf akademik, etj. Forma të tjera të vlerësimit të programit janë mendime të gjeneruara nga pedagogët, veçanërisht stafi i jashtëm, nga Zyra e Rekrutimit, Këshillimit.
- Anketime çdo semester, dy javë përpara mbarimit të tij, me secilin grup, çdo vit, dy herë., duke përdorur formate vlerësimi të lidhura me procesin akademik.
 - Numri studentëve pjesëmarrës varion. në varësi dhe të studentëve të pranishëm në momentin e kryerjes.
 - Instrumentat e vlerësimit trajtojnë çështje që lidhen me cilësinë e programeve të lëndëve, përmbajtjen dhe qartësinë e tyre, metodat e mësimdhënies, raportin teori / praktikë, metodat e vlerësimit, materialet mbështetëse, plotësimin e formimit profesional.
 - Të gjithë pytesorët përpunohen dhe rezultate i paraqiten me shkrim Rektorit. Rezultatet e tyre bëhen pjesë e diskutimeve në Senat. Të dhënat e raportit të vlerësimit vihen në dispozicion të pedagogëve individualisht dhe përdoren në fillim të vitit të ri akademik në funksion të përmirësimit të rishikimit të syllabus-eve dhe përmirësimit të procesit mësimdhëns në program.
 - Studentët gjithashtu njoftohen për rezultate e vlerësimeve të tyre për çështje të përmirësimit të kurrikulave dhe të mësimdhënies.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj); Dëgjime në auditor; Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë; Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.); Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës; Etj. 	<p>Institucioni ka një dokument të politikës së vlerësimit dhe një paketë me instrumente për vlerësimin e programit. Përdoret vlerësimi formues dhe përmbledhës.</p> <p>Informacioni për vlerësimin e programit të studimit është përfshirë në raportin e vlerësimit të brendshëm. Si procedurë, Rektori nxjerr urdhër mbi ngritjen e një grupi vlerësimi, që përbëhet nga 2 përfaqësues të NJSBC dhe 2 përfaqësues të departamentit/programit, si dhe koordinatorin e programit.</p> <p>SHLUJ UMB i ka bërë publike rezultatet e vlerësimit të brendshëm në Senatin e Universitetit, ua ka komunikuar pedagogëve dhe studentëve. Ai është i aksesueshëm në ëbsite-in e universitetit.</p> <p>SHLUJ UMB ka përcaktuar metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për kryerjen e vlerësimit, të brendshëm, të përfshira në një paketë me instrumente të vlerësimit.</p> <p>Janë përdorur procedurat dhe instrumentet e mëposhtme:</p> <p>Zhvillohen monitorime në fund të procesit të mësimdhënies.</p> <p>Një raport i përmbledhur vlerësimi i vihet në dispozicion Rektorit, bazuar në vlerësime nga studentët për çdo lëndë. Kjo ndihmon direkt në rishikimin periodik të syllabuseve. Për këtë qëllim përdorem Formularë vlerësimi për çdo lëndë si dhe pyetësorë që synojnë vlerësimin e gjithë Kurrikulës. Marrja e Feedback-ut nga studentët që ndjekin programin e e studimitve dhe pedagogët Vëzhgimi i rezultatet e studentëve në provime dhe në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (detyra kursi, projekte, punë individuale, punë në grup) janë një tjetër metodë e përdorur. Rezultate të provës finale.</p> <p>Vëzhgime realizohen edhe gjatë kryerjes së praktikës.</p>
Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.	

<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>SHLUJ UMB ka përgatitur raporte dhe buletine për vlerësimin e brendshëm.</p> <p>Raporti vlerësimit të brendshëm publikohet në ëbsite-in e universitetit.</p>
<p>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Bazuar në rezultatet e vlerësimit të brendshëm institucioni harton një analizë vjetore, ku propozohen dhe ndryshime eventuale për programin në vitin e ri.</p>
<p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Po</p> <p>Instrumentat e sipër përmendur garantojnë cilësinë e programit.</p> <p>Studentët dhe pedagogët ishin mjaft mirë të informuar dhe ndërgjegjësuar mbi rëndësinë e sigurimit të cilësisë dhe përdorimin e metodave të përmenduar më lart. Ata informohen dhe në mënyrë konfidenciale mbi problematikat specifike të lëndëve përkatëse.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p>	
<p>Institucioni ka ngritur Njësinë e Vlerësimit të Brendshëm, që zhvillon periodikisht vlerësime mbi programet dhe procesin mësimor, në funksion të rritjes së cilësisë. Vlerësimet përdorin metoda e larmishme dhe përfshirja e të studentëve në vlerësimin e programit është një pikë e fortë e këtij sistemi. Rezultatet e vlerësimeve vihen në dispozicion të personelit akademik dhe studentëve dhe cdo fillim viti akademik shërbejnë për të përmirësuar currikulën dhe cilësinë e programit.</p> <p><i>Standardet që lidhen me sigurimin e cilësisë janë përmbushur.</i></p>	

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Programi “*Master Profesional në Sociologji Zhvillimi me profil Zhvillim Social Komunitar*” synon formimin akademik të specialistëve të sociologjisë, për t’iu përgjigjur kërkesave të zhvillimit social të shoqërisë shqiptare, në kontekstin e zhvillimeve bashkëkohore evropiane e globale. Ai synon të përgatitë specialistë me koncepte dhe aftësi teorike e metodologjike për studimin – me këndvështrimin dhe metodat konkrete të

sociologjisë bashkëkohore – të problemeve të zhvillimit social komunitar. Programi synon përgatitjen e dyfishtë, si profesionistë të fushave relativisht të reja dhe si qytetarë aktivë të një shoqërie demokratike. Përgjithësisht programet e lëndëve janë në përputhje me misionin dhe objektivat e programit.

Programi është zhvilluar në 2 semestra të shpërndarë gjatë më shumë se dy viteve kalendarike (2012-2014, aktualisht ka mbetur pa u realizuar mbrojtja e diplomave për 5 studentë. Programi përmban 6 lëndë në 3 semestra (2 lëndë të zhvilluara në auditore për çdo semestër), një praktikum (veprimtari e bazuar në drejtimin e shkollës) dhe mbrojtja e tezës përfundimtare në semestrin e tretë. Semestrat kanë zgjatur mesatarisht 4-5 muaj duke qenë se orari zhvillohet vetëm në dy ditë në javë. (shiko planin mësimor për më shumë detaje).

Tregues të matshëm:

- Viti i fillimit, qëllimi dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi ka filluar në vitin 2012.

- Organizimi i çdo programi studimi (vite, semestra, javë, etj..)

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në audior
- 1 semester varion 13-15 javë mësimore në auditor
- 1 ECTS = 25 orë mësimore pune të studentit
- 1 orë mësimore = 60'

- Emërtimi i Diplomës për programin e studimit “*Master Profesional në Sociologji Zhvillimi me profil Zhvillim Social Komunitar*”.

- Plani mësimor sipas tabelës më poshtë.

PLANI MËSIMOR PËR PROGRAMIN E STUDIMIT MP NË SOCIOLOGJI ZHVILLIMI / ZHVILLIM SOCIAL KOMUNITAR 2012-2013								
Nr	Emërtimi i lëndëve	Semestri		Shpërndarja e ngarkesës mësimore				
			ECTS	Orë leksione në auditor	Orë në auditor për aktivitetet të tjera (seminare, detyra, punime,..)	Orë gjithsej për studim individual	Totali i orëve	
Formim baze								
1	Shoqëria dhe zhvillimi i qëndrueshëm	I	6	40	20	90	150	
2	Probleme Sociale bashkëkohore	I	6	40	20	90	150	
Formim kerkimor								
3	Metodat e Aplikuara të Kërkimit	I	7	40	30	105	175	
Formim i specializuar								
4	Komunitarizmi si teori dhe praktikë	I	7	40	30	105	175	

5	Demokracia pjesëmarrëse e Shoqëria civile	II	7	40	30	105	175
6	Sociologjia e suksesit	I	6	40	20	90	150
7	Praktikum në fushë: veprimtari e bazuar në drejtimin e shkollës	II	5		75	50	125
8	Prova finale: tezë kërkimi empirik ose dosje profesionale	II	16		135	265	400
TOTALI: 60ects				240	360	900	1500

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- Për leksionet 240 orë në auditor dhe ____orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret 155 orë në auditor dhe 585 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën Profesionale 75 orë në auditor dhe 50 orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar 135 orë në auditor dhe 265 orë punë e pavarur e studentit

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Lënda/Moduli	Pedagogu përgjegjës	Titulli/ grada	Departamenti	Statusi PAE/PAK
1.Shoqëria dhe zhvillimi i qëndrueshëm	Reis Mulita	Dr.	Departamenti i biznesit menaxhimit dhe turizmit	PAE
2.Probleme Sociale bashkëkohore	Stavri Sinjari	Dr.	Departamenti i shkencave sociale dhe edukimit	PAK
3.Metodat e Aplikuara të Kërkimit	Lekë Sokoli	Dr.	Departamenti i shkencave sociale dhe edukimit	PAK
4.Komunitarizmi si teori dhe praktikë	Msc.Altina Peshkatari	Msc.	Departamenti i shkencave sociale dhe edukimit	PAK
5.Demokracia pjesëmarrëse e Shoqëria civile	Marjana Cadri	Dr.	Departamenti i shkencave sociale dhe edukimit	PAK
6.Sociologjia e suksesit	Lekë Sokoli	Dr.	Departamenti i shkencave sociale dhe edukimit	PAK

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë

Të gjitha programet e lëndëve/syllabuset i përmbahen strukturës së mëposhtme.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda

- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojnë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi është i organizuar në lëndë mësimore të vlerësuara me kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Lëndët i përkasin 3 kategorive të formimit bazë (2), të kërkimit (1) dhe të specializuar (5). Ato variojnë me 5-7 kredite (ECTS), vec provës finale që ka 16 kredite (ECTS).</p> <p>Plani mësimor i këtij programi parashikon ngarkesën me 60 kredite, edhe pse zhvillohet me kohë të pjesshme.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p>	<p>Programi “Master Profesional në Sociologji Zhvillimi me profil Zhvillim Social Komunitar” ka përcaktuar objektiva dhe kompetenca cilat plotësojnë aftësitë dhe njohuritë e marra në nivelin Bachelor, me një profil më të qartë eksplorues dhe kërkimor, por më pak praktik.</p> <p>Struktura dhe përmbajtja e planit mësimor si dhe ajo e programeve të lëndëve specifike, synojnë të pajis studentët me njohuri të avancuara teorike, me aftësi për kërkim shkencor dhe vlerësime të situatave sociale të zhvillimit të komunitetit, vecanërisht nëpërmjet lëndëve “Demokracia pjesëmarrëse e Shoqëria civile” dhe “Sociologjia e suksesit”.</p> <p>Programi nuk rezulton të sigurojë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar me ligj.</p> <p>Nga vlerësimi i syllabuseve të lëndëve rezulton se programi i studimit i pajis studentët me kompetenca të përgjithshme dhe specifike sipas përshkrimit të tyre si p.sh. në nivelin e aftësive teorike e aplikative për studimin e jetës shoqërore, trajtuar dhe zgjidhur probleme, për të hartuar rekomandime, etj., por duket</p>

<p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>se ka mangësi në pajisjen e tyre me aftësi për të menaxhuar projekte.</p> <p>Ky kriter nuk aplikohet për këtë program Programi “Master Profesional në Sociologji Zhvillimi me profil Zhvillim Social Komunitar” synon formimin profesional të specialistëve të sociologjisë, vecanërisht në çështje të zhvillimit social të komunitetit, në kuadër të institucioneve që merren me planifikimin dhe programet zhvilluese të tij, si për shembull institucionet e qeverisjes lokale apo OJF të ndryshme me këtë fokus.</p>
<p>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodot e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Objektivat e programit përputhen me ato të studimeve të nivelin e dytë, pra me ofrimin e njohurive dhe kompetencave të avancuara në fushën e sociologjisë dhe zhvillimit komunitar, si një nga drejtimet e rëndësishme të praktikës dhe punës me komunitetet. Ato përputhen me standartet e sistemit të Bolonjës.</p> <p>Syllabuset e lëndëve dëshmojnë për një vlerësim të vazhdueshëm gjatë gjithë semestrit të studentëve nëpërmjet kombinimit të metodave të ndryshme të tilla si: detyra kursi, studime rasti, projekte, analiza dokumentesh dhe provim përfundimtar (me gojë ose me shkrim). Strategjia/metodologjia e vlerësimit është e reflektuar në të 6 programet e lëndëve/syllabus-et.</p>
<p>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikat e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Hartuesit e programit të “Master Profesional në Sociologji Zhvillimi me profil Zhvillim Social Komunitar”, njëkohësisht perdagogë të lëndëve të ndryshme dëshmojnë se në hartimin e tij i janë referuar përvojës së disa universiteteve me të cilat institucioni bashkëpunon, si Universitetit të Kardiffit, i Bolonjës, Udines si dhe ai i Clemson në SHBA.</p> <p>Programi i ofruar përmban elemente që respektojnë standartet ndërkombëtare të kurrikulës universitare, të përcaktimit të krediteve, të kriterëve të pranimit si dhe përpiqet t’i integrojë ato me vlerat e arsimit universitar në Shqipëri. Përfshirja e rubrikave të tilla si: të dhëna të përgjithshme, misionin, objektivat, rezultatet e të nxënit, planin mësimor, organizimin mbi bazën e krediteve, përcaktimin e kriterëve të pranimit, metodologjinë e mësimdhënies dhe të vlerësimit, dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të transferimit të krediteve, bën që programi i studimit të përmbushë kriterin për të qenë i konkurrueshëm ndërkombëtarisht për nga elementët e përmbajtjes.</p> <p>Programi është hartuar në frymën e përgjithshme të legjislacionit dhe direktivave të BE për arsimin e lartë., vecanërisht bazuar në përvojën e Projektit evropian TUNING.</p>
<p>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit</p>	<p>Programi “Master Profesional në Sociologji Zhvillimi me profil Zhvillim Social Komunitar” synon pajisjen e</p>

<p>të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>studentëve me aftësi profesionale dhe të kërkimit në fushën e sociologjisë së zhvillimit. Aftëtit praktike synohen të realizohen nëpërmjet praktikës profesionale dhe ofrimit të modeleve të mira praktike. Ndërsa aftësimi për kërkimin shkencor realizohet si nëpërmjet lëndës së Metodave të kërkimit, që aplikon kërkimi të aplikuar si përbërëse të provës finale.</p> <p>Programi “Master Profesional në Sociologji Zhvillimi me profil Zhvillim Social Komunitar” ofrohet nga një prej 3 Fakulteteve të Institucionit, cili rezulton të jetë dhe një nga drejtimet më të rëndësishme studimore të tij.</p> <p>Përmbajtja e syllabus-eve, dosjet personale të pedagogëve dhe lista e të dhënave për kërkimin shkencor dëshmojnë se pedagogët e këtij programi janë të angazhuar në veprimtarinë kërkimore shkencore dhe kjo veprimtari vihet në dispozicion të mësimdhënien dhe realizimin e synimeve të programit të studimeve.</p> <p>Bazuar në dokumnetacionin mbi CV e pedagogëve rezulton se puna e tyre kërkimore është në funksion të arritjes së synimeve të programit.</p>
--	--

Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>Programi i referohet në mënyrë të drejtpërdrejtë “zhvillimit” – të marrë si zhvillim social komunitar, duke e konsideruar këtë si një prej sfidave të shoqërisë shqiptare. Në këtë kontekst programi tenton të jetë konkurrues në raport me nevojat e tregut për specialistë të zhvillimit të komunitetit.</p> <p>Në situatën e një shoqërie në zhvillim ekonomik dhe social dinamik dhe tendencave të dukshme të shoqërisë shqiptare për transformimit, programi synon të plotësojë nevojat për specialistë të sociologjisë së zhvillimit.</p>
---	--

Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; b. kërkesat e punëdhënësve; c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Programi duke u fokusuar në vlerësimin e komuniteteve dhe burimeve të tij, punën me to për një zhvillim të qëndrueshëm kontribuon në përgatitjen e specialistëve të kësaj fushe studimore në përafrim edhe me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik e kombëtar.</p> <p>Institucioni rezulton të ketë kryer investigime dhe anketime për kërkesat e tregut vendas dhe rajonal për specialistë të zhvillimit social, kërkesat e punëdhënësve, gjë që ka mundësuar parashikimin e numrit të studentëve të mundshëm për të ndjekur programin.</p>
---	---

Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.

<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Jo</p> <p>Shih më sipër.</p>
<p>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>Ky kriter nuk aplikohet për këtë program.</p>
<p>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p>Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Studentëve u vihen në dispozicion në fillim të studimeve, rregullorja e studimeve, plani mësimor, programet e lëndëve, orari i mësimit, ndërsa paketa e praktikës dhe e provës finale jepen në periudhën para fillimit të tyre. Broshura, fletëpalosje dhe faqja e internetit të SHLUJ UMB shërbejnë gjithashtu si burime informacioni për studentët dhe publikun e interesuar.</p>
<p>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</p>	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p>Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Shih më sipër.</p> <p>Në program janë parashikuar 7 kredite për formimin kërkimor dhe 16 kredite për provën finale.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p>	
<p>Fakulteti i Drejtësisë Shkencave sociale dhe Politike me strukturat përkatëse për zhvillimin e programeve master ka mundur të administrojë me efektivitet programin e studimit Master Profesional në Sociologji Zhvillimi me profil Zhvillim Social Komunitar. Ky program është ndërtuar në respekt të ruajtjes së vlerave kulturore dhe interesave kombëtare, të cilat reflektohen nëpërmjet përmbajtjes mësimore, kërkimit dhe veprimtarive. Programi i studimit dhe programet e lëndëve zhvillohen sipas standardeve. Po ashtu Departamenti përgjegjës ka bërë një shpërndarje korrekte të ngarkesës mësimore në kredite duke respektuar standardet e kërkuara.</p> <p>Informacioni mbi programin, rregulloret dhe të tjera për studentët dhe publikun e interesuar ofrohet në si mjediset e institucionit nëpërmjet zyrave të informacionit, por edhe nëpërmjet fletëpalosjeve, broshurave dhe faqes së internetit.</p> <p><i>Standardet janë përmbushur.</i></p>	

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Bazuar në programet e lëndëve dhe opinionet e studentëve rezultojnë se mësimdhënia organizohet duke kombinuar format bazë të leksioneve, seminareve, prazantimeve të detyrave të studenteve, prezantimi i videove të ndryshme në varësi të temave dhe diskutimit në lidhje me to. Zhvillimi i leksioneve lehtësohet nga përdorimi i prezantimeve në poëer-point. Aktivizimi i studentëve stimulohet nëpërmjet përfshirjes së tyre në diskutime,

punë në grupe, teste, përdorimit të elementëve të punës së pavarur të procesit kërkimor dhe prezantimin e detyrave të kursit. Vlerësimet variojnë sipas lëndëve dhe kritereve që përdoren. Studentët në disa raste janë bërë pjesë e projekteve të Fakultetit apo qendrave kërkimore të UMB.

Tregues të matshëm:

- Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

Programi i studimit MP në Sociologji Zhvillimi me profil Zhvillim Social Komunitar		
	Format e mësimdhënies	Orë totale në auditor
a	Leksione	240
b	Seminare	150
c	Ushtrime	
d	Laboratore	
e	Praktike lëndore	
f	Praktikë profesionale në institucion	75
g	Prova finale	135
	Në total	600

Format e kontrollit të njohurive

Format e kontrollit të njohurive	Pjesa në % ndaj totalit
Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive	10%
Plotësimi detyrimeve (detyra kursi, studime rasti, lexime etj)	30%
Testime gjatë vitit	20%
Provim përfundimtar	40%
Në Total	100%

- Aktivizimi i studenteve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Aktiviteti shkencor i IAL	Numri i studentëve të aktivizuar
Për punime shkencore individuale të pedagogëve	
Për projekte shkencore në rang Departamenti	5
Për projekte shkencore në rang Fakulteti	12
Për projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë	10

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Institucioni ka zhvilluar një politikë të pranimit të studentëve, me kriteret dhe procedurat e pranimit, me statusin e studentëve, të drejtat dhe përgjegjësitë e studentëve, përgjegjësitë e SHLUJ UMB për studentët të përcaktuara në Rregulloren e studimeve për Programin “Master Profesional në Sociologji Zhvillimi me profil Zhvillim Social Komunitar”, Kreu V dhe VI.

Institucioni ka përcaktuar kriteret dhe procedurat e pranimit në rregulloren e studimeve të cilat përfshijnë:

- Të zotërojë një diplomë universitare “Bachelor” ose një diplomë tjetër studimi të fituar brenda apo jashtë vendit, të vlerësuar ekuivalente me të në fushën përkatëse ose në fusha të përafërta me programin për të cilin aplikon. Në rastin kur diploma nuk përputhet me fushën e përafërimit të kërkuar, departamenti që mbulon programin përkatës të studimeve master vlerëson nëse kualifikimet dhe përvoja në fushë janë të mjaftueshme apo përcakton nëse kandidati duhet të realizojë një program përafrimi.
- Të ketë rezultate të mira akademike të studimeve bachelor
- Të ketë përvojë pune mbi një vit
- Të zotërojë dëshmi të gjuhës angleze ose të japë provimin e gjuhës angleze në përfundim të studimeve mbi bazën e një testimi të njohur ndërkombëtar
- Të arrijë rezultate të mira në çdo testim pranimit ose intervistë të kërkuar nga departamenti që mbulon Programin Master
- Të shprehë qartë qëllimin e ndjekjes së studimeve në Programin “Master Profesional”
- Të jetë i rekomanduar nga dy persona të cilët i njohin aftësitë akademike, profesionale, kerkimore dhe personale të kandidatit
- Të përballojë shpenzimet e shkollimit.

Gjithashtu SHLUJ Universiteti Marin Barleti pranon transferime të studentëve në vitet e ndërmjetme nga shkollat e tjera universitare vendase dhe të huaja, publike ose jo publike dhe lejon transferimin e studentëve të saj në shkollat e tjera sipas disa procedurave dhe një dokumentacioni të kërkuar, sipas rregullores së transferimeve. Por në këtë program nuk ka patur transferime dhe as largime të studentëve.

Programi	Studentë të regjistruar ne vitin e parë (për herë të parë)	Nota Mesatare	Studentë të diplomuar vitin e parë (pa vite përsëritëse)	Nota Mesatare
Zhvillim Social Komunitar	8	7.7	3	9
Total	8			

Të dhëna për punësimin e studentëve

Periudha e të dhënave (2012 – 2015)

Program i studimit në MP Zhvillim Social Komunitar	Numri total i të diplomuarëve	Numri total i të punësuarëve (në përputhje me diplomën)	Numri total i të punësuarëve (jo në përputhje me diplomën)
8	3	2	-

Duke qenë se programi është në proces rezulton se vetëm 3 studentë kanë realizuar tezen dhe mbrojtjen e diplomës kurse pjesa tjetër janë në zhvillim e sipër. Ende nuk është përfunduar diplomimi.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>Nga verifikimi në dosjet e studentëve rezultoi se të gjithë studentët e programit zotëronin diplomën Bachelor në sociologji apo fusha të përafërta studimi.</p> <p>Studentët e pranuar në Programin “Master Profesional në Sociologji Zhvillimi me profil Zhvillim Social Komunitar” rezultojnë të kenë plotësuar kriteret e përcaktuara në Rregulloren e Studimeve. Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit, i cili ka bërë përzgjedhjen e studentëve bazuar në të dhënat e tyre personale.</p> <p>Dosja personale e studentit të mbajtura në sekretarinë mësimore përmbajnë: formularin e aplikimit, mandatet e arkëtimit për pagesat e regjistrimit, listën e notve të studimeve Bachelor, kopje të noterizuar të diplomës së nivelit të parë, CV dhe fotokopje dokumenti identifikimi. Nga verifikimi i tyre rezultoi se në 2 dosje mungonin CV-te dhe në një tjetër dëshmia e gjuhës së huaj.</p> <p>SHLUJ UMB ofron kurse gjuhe dhe në bashkëpunim me PEARSON Testing Center ofron mbrojtjen e gjuhës angleze me test ndërkombëtar, që shtë një mundësi e mirë për studentët të marrin këtë dëshmi brenda institucionit.</p> <p>Edhe pse institucioni teton të rivlerësojë politikat e pranimit kundrejt ndryshimeve në legjislacionin të arsimit të lartë dhe kërkesave të tregut të punës, personeli akademik dëshmon se është një proces i vështirë për shkak të konkurrencës së pandershme në tregun e IAL-ve apo informaliteteit të tregut të punës dhe profesioneve.</p>
Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Institucioni ka dy zyra që japin informacion për mundësitë e punësimit dhe ofrojnë shërbimin e këshillimit. Zyra e Karrierës mbështet në mënyrë aktive të diplomuarit në planet e tyre për karrierën dhe përshtatjen me tregun e punës, sidomos ata të nivelit të parë.</p> <p>Njëësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Njëësia e Programeve Master ofron informacion për akreditimin e institucionit, të programeve të studimit, për procedurat e njohjes dhe vlefshmërisë së diplomave brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Studentët që kanë ndjekur programin “Master Profesional në Sociologji Zhvillimi me profil Zhvillim Social Komunitar” kanë qenë të</p>

	<p>punësuar. Asnjë prej tyre nuk është punësuar akoma për shkak të ndjekjes së këtij programi.</p>
<p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Institucioni disponon të dhëna statistikore mbi numrin e të diplomuarve në programet e ndryshme të studimeve që kanë përfunduar. Në këtë program akoma nuk ka studentë të diplomuar.</p> <p>Në Programin “Master Profesional në Sociologji Zhvillimi me profil Zhvillim Social Komunitar ” për vitin akademik 2012-2013 janë regjistruar 8 studentë, nga të cilët 3 kanë mbrojtur diplomën dhe 5 janë në proces.</p> <p>Nga të dhënat e vëna në dispozicion rezultojnë se mesatarja në hyrje ka qenë 7.7, ndërsa në dalje është rritur në 9. Nuk është larguar asnjë student . Nuk është diplomuar asnjë prej 8 studentëve të programit.</p> <p>Në Sekretarinë Mësimore të Ciklit të Dytë të studimeve u verifikua prezenca e regjistrave me të dhëna të plota mbi rezultatet/vlerësimet në lëndët e ndryshme, tregues dhe të ecurisë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim. Disponohen gjithashtu të dhëna mbi performancën e studentëve dhe mesataret e ponderuara në përfundim të studimeve, që shënohet në pasqyrën e rezultateve të studentit që diplomohet.</p>
<p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Akoma asnjë student nuk është punësuar pas diplomimit.</p> <p>Institucioni disponon të dhëna mbi doktorantët që ndjekin programin doktorial me Clemson University në Shqipëri.</p>
<p>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Studentët janë të informuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe statusin e akreditimit të programit.</p> <p>Ata janë të informuar për rezultatet e vlerësimit gjatë programit dhe në përfundim të tij.</p> <p>Komunikimi midis pedagogët dhe studentëve është i vazhdueshëm dhe vlerësohet nga vetë</p>

	studentët si i vlefshëm, si për procesin e të nxënit ashtu dhe vlerësimet apo rezultatet akademike.
Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.	
Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;	SHLUJ UMB i ndihmon studentët për çështje të procesit mësimor nëpërmjet këshillimit që ofron Zyra e Karrierës, në nivel departamenti, apo nga pedagogët individualë.
Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.	Zyra e Karrierës dhe sidomos koordinatori i programit orientojnë dhe asistojnë studentët në përzgjedhjen e institucioneve për zhvillimin e praktikës profesionale.
Konkluzionet e vlerësimit:	
<p>Institucioni bën përpjekje serioze për të respektuar të drejtat e studentëve për informacion, i asiston ata nëpërmjet strukturave përgjegjëse në çështje mësimore dhe praktikës profesionale. Rregjistrimi, menaxhimi dhe ruajtja e të dhënave të studentëve kryhen elektronikisht dhe me shkrim dore në rregjistra pranë sekretarisë mësimore. Dokumentacioni i verifikuar pranë sekretarisë mësimore si mbi arritjet akademike ashtu edhe mbi dosjet personale ishte përgjithësisht i plotë dhe korrekt, me ndonjë mungesë në dosje të CV-ve dhe dëshmisë së gjuhës së huaj.</p> <p>Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar, për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë MP si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik. Asnjë student i këtij programi nuk është larguar apo diplomuar.</p> <p><i>Standardet që lidhen me të drejtat e studentëve janë përmbushur.</i></p>	

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

SHLUJ Universiteti Marin Barleti ka një politikë të kërkimit dhe strukturat e posaçme të kërkimit për përmbushjen e kësaj politike. Në UMB funksionon Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit "Barleti" (BIRD) si dhe Instituti Shqiptar për Çështje Publike (AIPA). Institutet synojnë të realizojnë qëllimin e tyre nëpërmjet kryerjes së punës studimore e kërkimore, trajnimeve, kurseve e konsultave, shërbimeve, veprimtarisë botuese dhe realizimit të projekteve të nivelit të lartë në të mirë dhe interes të publikut. Këto struktura kërkimore synojnë të bashkëpunojnë me institucione të tjera kërkimore-shkencore si dhe agjencitë e zhvillimit në rajon e më gjerë për organizimin e veprimtarive të përbashkëta si dhe të bëhen pjesëmarrës aktiv në rjetet ndërkombëtare të institucioneve të kërkimit dhe zhvillimit. Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit Barleti dhe Instituti Shqiptar për Çështje Publike janë ngritur posaçërisht për t'i shërbyer qëllimit kryesor të kërkimit, duke u bërë krahu kryesor i SHLUJ Universiteti Marin Barleti në këtë drejtim. Institutet janë njësi të angazhuara tërësisht në kërkimin që fokusohet jo vetëm në organizimin e mirë dhe rritjen e kapaciteteve të Universitetit por edhe në krijimin e një mjedisi të angazhuar në kërkim brenda tyre, që mbështet përpjekjet kërkimore dhe gjenerimin e një tërësie rrethanash të volitshme për kërkimin në kontekstin e gjerë socio-ekonomik të Shqipërisë.

Një ndër objektivat kryesore të Universitetit dhe Instituteve është realizimi, nëpërmjet stafit të brendshëm dhe atij të atashuar, i kërkimeve cilësore në fushat e veprimtarisë që mbulohen prej tyre, jo vetëm në bashkëpunim me njëri-tjetrin, por edhe me institucione të tjera kërkimore-shkencore brenda dhe jashtë vendit. Vetë stafi akademik i Universitetit Marin Barleti realizon punë kërkimore-shkencore kryesisht si staf i angazhuar pranë qendrave, departamenteve apo Instituteve, si punonjës kryesorë kërkimor-shkencorë, lektorë apo koordinatorë projektsh kërkimore.

Studimet kërkimore shkencore në SHLUJ UMB kryhen në veçanti, në fushat e mëposhtme:

- 1) tregu i brendshëm;
- 2) kohezioni social;
- 3) siguria e ushqimit dhe konsumatorit;
- 4) zhvillimi i qëndrueshëm;
- 5) çështjet ekonomike dhe monetare;
- 6) rinia, edukimi dhe formimi profesional;
- 7) punësimi dhe çështjet sociale;
- 8) ndërmarrjet;
- 9) mjedisi;
- 10) marrëdhëniet me jashtë;
- 11) të drejtat e njeriut;
- 12) marrëdhëniet institucionale;
- 13) politikat dhe zhvillimet rajonale;
- 14) zhvillimi rural
- 15) çështjet gjinore

Studimet e zhvilluara nga stafi akademik i UMB publikohen periodikisht në revistën "Gjeopolitika", në Revistën Studime Sociale, botim i Institutit të Sociologjisë si dhe në revista të tjera të njohura ndërkombëtarisht. Kjo Revista publikohet një herë në tre muaj duke u fokusuar në çështje tematike të rëndësishë bashkëkohore. Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit "Barleti" është në proces të përgatitjes së një reviste tjetër shkencore që do të mbulojë fushat kryesore të veprimtarisë shkencore në UMB dhe do të mundësojë ndarjen e rezultateve të kërkimeve shkencore.

Tregues të matshëm:

Aktivitete të planifikuara individuale dhe në rang Institucioni në vitet e fundit		
1.	Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL	7 botime monografike, apo me bashkautorësi – dy në vit; 6 numra të rinj revistash shkencore mbështetëse të programit – dy në vit; 40 artikuj të botuar në revista shkencore, brenda e jashtë Shqipërisë (dhjetë në vit)
2.	Numri i projekteve kërkimore të fituara	7 projekte të fituara, në të cilat janë përfshirë pedagogë të departamentit, si: Tempus, Migrimi ndërkombëtar i Shqiptarëve (sondazh); Interesi për të vazhduar studimet e larta (sondazh); Gratë në konflikt, etj.
3.	Numri i projekteve të zbatuara	7 projekte të zbatuara, në të cilat janë përfshirë pedagogë të departamentit
4.	Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL	9 (tre në vit)
5.	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda iAL	Të gjithë, 22 studentë dhe 7 pedagogë; në total mbi 100 studentë (bashkë me departamentet e tjera)
6.	Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor	Të gjithë studentët dhe pedagogët e këtij programi janë përfshirë në forma të ndryshme në kërkimin shkencor
7.	Numri i studentëve të përfshirë	Të gjithë studentët dhe pedagogët e këtij programi janë përfshirë

	në kërkimin shkencor	në forma të ndryshme në kërkimin shkencor
8.	Numri i Çmimeve Kombëtare	• (një)

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Nga dosjet personale, syllabuset por edhe të dhënat statistikore të institucionit rezulton se personeli akademik në këtë Program është i angazhuar aktivisht në veprimtari të publikimit të artikujve, kërkimeve shkencore dhe materialeve të tjera shkencore në fushën e sociologjisë dhe zhvillimit të komunitetit.</p> <p>Kjo veprimtari kërkimore e personelit akademik përbën një kontribut për zhvillimin e programit të studimit në fushën e shkencave sociale.</p>
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Prof.Dr. Berteke Eëaldijk nga Universiteti i Utrechtit, Holandë ka zhvilluar leksionin me temë “Kontekste që ndryshojnë: Studimet gjinore dhe qytetaria në Europë” në gjuhë të huaj.</p> <p>Sic shihet ai është i huaj.</p>
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>Institucioni raporton të ketë organizuar dy programe kualifikimi dhe zhvillimi profesional për personelin akademik të drejtuar nga prorektori për kërkimin dhe studimet pasuniversitare dhe Qendra e Ekselencës në Mësimdhënie dhe të Nxënit. Të dy programet kanë synuar aftësimin për përdorimin e metodologjisë bashkëkohore të mësimdhënies, për hartimin e programeve lëndore, specifikat e mësimdhënies me të rriturit, prirjet e zhvillimit të arsimit të lartë, bashkëpunimin me biznesin. Në seancat e kualifikimit kanë marrë pjesë edhe pedagogë e jashtëm.</p> <p>Institucioni nuk financon drejtpërdrejt kualifikimet e pedagogëve, por iu jep mundësinë atyre nepërmjet kohës në dispozicion për kërkim shkencor.</p>
Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në</p>	<p>Institucioni disponon të dhënat për studimet shkencore të pedagogëve të Programit “Master Profesional në Sociologji Zhvillimi me profil Zhvillim Social Komunitar”, të pasqyruara këto dhe në dosjet personale të tyre. Këto të dhëna</p>

<p>konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi; Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>përfshijnë pjesëmarrjen dhe kumtimet në konferenca, artikujt shkencorë.</p> <p>Në bibliotekëm e institucionit gjenden të depozituara kopje të botimeve të pedagogëve të Programit “Master Profesional në Sociologji Zhvillimi me profil Zhvillim Social Komunitar”, duke përfshirë botimet tekstesh, studimesh, artikuj apo kumtesa, të cilat mund të shfrytëzohen edhe nga studentët, të ndikuara edhe nga syllabuset e lëndëve të programit. (shembuk botime të DR. L.Sokolit, Dr. Reis Mulitës, etj.)</p> <p>Vetë institucioni ndërmerr veprimtari shkencore apo projekte në të cilat pedagogët dhe studentët kanë mundësi të angazhohen.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Personeli akademik i programit është i angazhuar në mënyrë të spikatur në veprimtari kërkimore dhe publikime, të cilat janë të reflektuara në dosjet e tyre personale, bibliotekën e Institucionit por edhe në përdorim të studentëve në punën studimore Institucioni mbështet këtë aktivitetet nëpërmjet këhës që lejon në dispozicion të kërkimit shkencor, qoftë duke i përfshirë ata në projekte që synojnë rritjen e cilësisë së mësimdhënies apo punën kërkimore.</p> <p><i>Standartet të plotësuara</i></p>	

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

SHLUJ UMB ka përcaktuar një politikë bashkëpunimi me partnerë vendas dhe të huaj në dobi të përmbushjes së objektivave të programeve që ofron. SHLUJ UMB ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me këto institucione:

Marrëveshje me universitete:

- Universiteti " Universum", Kosovë,15 Prill 2007
- Universiteti për Biznes dhe Teknologji,Prishtinë, Kosovë, 7 Mars 2008
- Universiteti Shtetëror i Tetovës, Maqedoni, 7 Mars 2008
- Universiteti "Fama", Kosovë, 12 Janar 2009
- Universiteti Clemson,South Caroline, USA, 8 Mars 2010
- Universiteti Ibero-American (UNIBE), Rep.Domenikane, 8 Mars 2010
- Universiteti "Mahidol", Tailand, 8 Mars 2010
- Universiteti i Prishtines, Kosove,8 Mars 2010
- Universiteti "South Bohemia" , Rep. Çeke,8 Mars 2010
- Universiteti "Free State", Afrikë e Jugut, 8 Mars 2010
- Universiteti "Ëestern Cape", Afrikë e Jugut, 8 Mars 2010
- Universiteti "Tallin", Estoni, 8 Mars 2010
- Universiteti Capital Normal, 14 Prill 2010
- Universiteti Cardiff, England,5 Maj 2010

- Universiteti i Udine-s, Fakulteti i Ekonomisë, Itali, 22 Qershor 2010
- Universita Degli Studi di Genova, Italia 13.01.2015
- Universita Degli Studi Roma Tre, Italia 18.09.2014
- Instituti Teknologjik i Epirit 10.05.2014
- Lappeenranta University of Technology, Finland 01.08.2013
- Universita Degli Studi Roma Tre, Italia 26.06.2013
- University of Arkansas Clinton School 03.04.2013
- University of Studies of Bari, Italy 31.03.2013
- Il Politecnico di Bari (POLIBA), Italia 31.01.2013
- Istituto Nazionale di Architettura, Roma, Italia 31.07.2012
- AHLEI (American Hotel & Lodging Educational Institution) 27.02.2012
- Istituto Nazionale di Architettura INARCH, Lazio, Italia 17.02.2012
- Pearson Language Tests, London, United Kingdom 25.01.2012
- Seconda Universita Degli Studi di Napoli, Italia 11.07.2011
- Bournville College, Birmingham United Kingdom 22.06.2011

Marrëveshje me shkolla dhe institucione shqiptare

- Ministri për Çështjet Vendore 21.06.2014
- Veneto Banka Tiranë 30.04.2014
- Komiteti Shqiptar i Helsinkit 31.03.2014
- Ministria e Kulturës 27.03.2014
- Shkolla Shqiptare e Administratës Publike 19.03.2014
- Njësia Bashkiake nr 1 05.03.2014
- Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit 04.03.2014
- Akademia e Shkencave të Shqipërisë 03.07.2013
- Shega Trans 30.06.2013
- Marketing and Distribution Albania 30.06.2013
- Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqsorë 04.06.2013
- Avokati i Popullit 29.04.2013
- Qendra për Nisma Ligjore Qytetare 07.04.2013
- Linja e Këshillimit për Gra e Vajza 07.04.2013
- Aleanca Gjinore për Zhvillim 07.04.2013
- USAID/Rritje Albania 17.03.2013
- Unioni i Gjyqtarëve 31.10.2012
- Agjencia e Shërbimeve të Sporteve 15.02.2012
- Shkolla “Internacional,” Vlorë 27.10.2011
- Gjumnazi “Nënshkruesi i Pavarësisë Nebi Sefa” 12.05.2011
- Gjumnazi “Dituria”, Lushnje 12.05.2011
- Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës 03.06.2010
- Qendra Ndëruniversitare e Studimeve Albanologjike 07.01.2010
- Universiteti Bujqësor i Tiranës 25.11.2008
- Ministria PÇS, Shërbimi Kombëtar i Punësimit 19.12.2007
- Ministria e Brendshme, Dept. i Administratës Publike 12.12.2007
- Zyra e Avokatisë Kalo & Associates 20.03.2007
- Studio Ligjore Hakani & Associates 16.03.2007
- Instituti i Studimeve Publike dhe Ligjore 14.03.2007

Marrëveshje me universitetet e rajonit

- Memorandum bashkëpunimi me universitetin AAB Prishtinë

- Memorandum bashkëpunimi me universitetin Shtetëror të Tetovës
- Universitetin për Biznes dhe Teknologji të Prishtinës (UBT)
- Memorandum bashkëpunimi me universitetin Dardania Prishtinë.

Po kështu ka marrëshje me institucione brenda vendit si: Avokati i Popullit, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve, Instituti European i Tiranës, Instituti Shqiptar i Sociologjisë, Internacional Sociological Association-ISA, European Sociological Association, ESA Balkan sociological Forum, BSF, Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillimetj. SHLUJ UMB gjithashtu ka nënshkruar edhe marrëveshje bashkëpunimi më disa nga agjensitë e rëndësishme të punësimit. (Shih dosjen e marrëveshjeve)

Tregues të matshëm:

Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

Aktivitete të planifikuara individuale dhe në rang Institucioni në dy vitet e fundit		
1.	Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL	2 Tekste mësimore 2 monografi 40 botime shkencore
2.	Numri i projekteve kërkimore të fituara	2 projekte të fituara (trajnimi i administratës lokale, Tempus)
3.	Numri i projekteve të zbatuara	2 projekte të zbatuara
4.	Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL	7 aktivite shkencore
5.	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda iAL	70 studentë të fakultetit , 8 anëtare të fakultetit, gjithsej
6.	Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor	Të gjithë studentët dhe pedagogët e këtij programi janë përfshirë në forma të ndryshme në kërkimin shkencor
7.	Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor	Të gjithë studentët dhe pedagogët e këtij programi janë përfshirë në forma të ndryshme në kërkimin shkencor
8.	Numri i Çmimeve Kombëtare	1

Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë

Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese	
Institucionet qeveritare bashkëpunuese:	Lloji i bashkëpunimit
Avokati i popullit	Trajnime, monitorime, pjesëmarrje në projekte
Institucioni in Ekzekutimit të Vendimeve	Trajnime, monitorime, pjesëmarrje në projekte
Instituti European i Tiranës	Trajnime, monitorime, pjesëmarrje në projekte
Instituti Shqiptar i Sociologjisë	Aktivitetete të përbashkëta shkencore
UT, Fakulteti i Shkencave Sociale	Mësimdhënie, aktivitetete të përbashkëta shkencore
Universiteti A Moisiu Durrës	Mësimdhënie, aktivitetete të përbashkëta shkencore
Universiteti I Qemali i Vlorës	Mësimdhënie, aktivitetete të përbashkëta shkencore
Universiteti Ndërkombëtar i Strugës	Mësimdhënie, aktivitetete të përbashkëta shkencore
UN Eomen	Projekte
Organizatat Profesionale:	
Internacional Sociological Association, ISA	Anëtarës të rregullt; Pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare
European Sociological Association, ESA	Anëtarësi; Pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare
Balkan sociological Forum, BSF	Anëtarësi; Pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare
Instituti Shqiptar i sociologjisë (AIS)	Partneritet, intershipe, konferenca shkencore; pjesëmarrje e studentëve në aktivitete dhe në projekte kërkimore.
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim	Trajnime, ekspertizë, intershipe
Qendra e Studimeve Ekonomike e Sociale (QSES)	Trajnime, ekspertizë, intershipe, pjesëmarrje e studentëve në realizim projektesh kërkimore
Komuniteti i biznesit, tregu i punës	
Instituti për demokraci e Ndërmjetësim (IDN)	Intershipe, vende pune për studentët
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim	Intershipe, vende pune për studentët
Qendra e Studimeve Ekonomike e Sociale (QSES)	Intershipe, vende pune për studentët

Lidhur me mobilitetin e studentëve të programit master profesional nuk ka patur ndonjë eksperiencë

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Institucioni ka nënshkruar marrëveshje me institucione publike dhe private, me fokus zhvillimin e praktikave mësimore si dhe promovimin e punësimit. (shiko listën e institucioneve dhe marrëveshjeve)</p> <p>Institucioni ka nënshkruar Marrëveshje e bashkëpunimit me një sërë institucionesh publike dhe sidomos OJF apo qendra studimore, me qëllim institucionalizimin e bashkëpunimit për realizimin e praktikës profesionale.</p>
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Rezulton një bashkëpunim midis personelit administrativ dhe atij akademik në funksion të realizimit të synimeve të programit.</p> <p>Detyra e personelit janë të përcaktuara. Në programin “Master Profesional në Sociologji Zhvillimi me profil Zhvillim Social Komunitar” ka një koordinatorë e cila kujdeset për sigurimin e komunikimit midis personelit akademik dhe studentëve.</p>
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Nuk ka ndonjë marrëveshje me institucione homologe që mbështet direkt programin në fjalë.</p> <p>Marrëveshje kryesisht me institucione shkollore apo OJF active në shoqërinë civile në Shqipëri.</p> <p>Nuk rezulton të ketë.</p> <p>Nuk rezulton të ketë.</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	
<p>Institucioni ka arritur të lidhë marrëveshje të mirëkuptimit apo bashkëpunimit me një sërë numër të konsiderueshëm partnerësh. Marrëveshjet e bashkëpunimi me partnerë publik dhe privat ndihmojnë në zhvillimin e aktivitetit mësimor, kërkimit dhe praktikës mësimore të studentëve. Bien në sy marrëveshjet e bashkëpunimit me OJF të cilat kanë një eksperiencë të gjatë dhe janë aktive në fushën e zhvillimit të komunitetit dhe civilizimit të shoqërisë.</p> <p><i>Standartet të plotësuara.</i></p>	

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR IMPLEMENTIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

RVJ mbyllet me “Analizën përmbledhëse të RVJ” sipas metodës SWOT (Strengths-pikat e forta, Weaknesses- pikat e dobëta, Opportunities-mundësitë, Threats-pengesat).

a. Pika të forta:

- 1) Misioni i institucionit synon të kombinojë ofertën akademike, kërkimin shkencor të aplikuar, përvojen aktive të studentëve, shërbime me vështrim ndaj sociologjisë së zhvillimit, si një nga drejtimet prioritare të studimeve dhe zhvillimeve sociologjike të aplikuara në vend.
- 2) Departamenti është përgjegjës për ofrimin e programit “Master Profesional në Sociologji Zhvillimi” me dy profile, njëri prej të cilëve “Zhvillimi Komunitar”, përcakton kriteret e përzgjedhjes së personelit akademik bazuar në fushat e ekspertizes dhe interesit të pedagogëve, luan rol në hartimin e kurrikulës, në vendimet institucionale që lidhen me organizimin e programit të studimit, procesin e vlerësimit të brendshëm dhe të përmirësimit të cilësisë. SHLUJ UMB ka respektuar standardin dhe cilësinë e personelit të angazhuar në programin “Master Profesional në Sociologji Zhvillimi me profil Zhvillim Social Komunitar” duke angazhuar në procesin mësimdhënës 5 pedagogë me gradën Dr. dhe vetëm një me MSc dhe eksperiencë pune mbi 5 vjet.
- 3) Mjediset fizike edhe pse të ndara në dy kampuse të veçanta, janë të bollshme, të larmishme në raport me funksionin dhe shërbimet për personelin e studentët. Mjediset janë të pajisura me pajisje në funksion të realizimit të procesit mësimor. Sallat e vogla të seminareve krijojnë mundësinë dhe fleksibilitetin e përdorimit të metodave interaktive të mësimdhënies. Laboratori i informatikës (kompjuter + programe kompjuterike SPSS) rezulton të jetë i efekshëm në zhvillimin e seminareve të lëndës së Metodave të Aplikuara të Kërkimit.
- 4) Institucioni ka ngritur struktura të vecanta për menaxhimin financiar dhe zhvillimin e auditit të brendshëm. Ai dëshmon qëndrueshmëri financiare dhe kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave.
- 5) Programi është ndërtuar në respekt të ruajtjes së vlerave kulturore dhe interesave kombëtare, të cilat reflektohen nëpërmjet përmbajtjes mësimore, kërkimit dhe veprimtarive.
- 6) Departamenti përgjegjës ka bërë një shpërndarje korrekte të ngarkesës mësimore në kredite duke respektuar standardet e kërkuara.
- 7) Institucioni garanton respektimin e të drejtës për informim të studentëve nëpërmjet ofrimit të informacionit mbi programin, rregulloret dhe të tjera, si për studentët astu dhe publikun e interesuar direkt në mjediset e tij apo metodave alternative bashkëkohore të informimit publik.
- 8) Sistem i sigurimit të cilësisë rezulton të jetë i konsoliduar, i vazhdueshëm dhe në funksion të përmirësimit të programit. Ai realizohet duke përdorur metodologji mikse të velërsimeve dhe me përfshirje të gjithë palëve të interesuara.
- 9) Institucioni disponon dokumentacion korrekt mbi studentët, statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve, numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë MP si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik. Rezulton se asnjë student i këtij programi nuk është larguar apo diplomuar.

- 10) Personeli akademik i programit është i angazhuar në mënyrë të spikatur në veprimtari kërkimore dhe publikime, të cilat janë të reflektuara në dosjet e tyre personale, bibliotekën e Institucionit por edhe në përdorim të studentëve në punën studimore. Institucioni mbështet këtë aktivitetet nëpërmjet këhës që lejon në dispozicion të kërkimit shkencor, qoftë duke i përfshirë ata në projekte që synojnë rritjen e cilësisë së mësimdhënies apo punën kërkimore.
- 11) Institucioni ka një listë të pasur marrëveshjesh të bashkëpunimi me partnerë publik dhe privat ndihmojnë në zhvillimin e aktivitetit mësimor, kërkimit dhe praktikës mësimore të studentëve. Marrëveshjet e bashkëpunimit me OJF të cilat kanë një eksperiencë të gjatë dhe janë aktive në fushën e zhvillimit të komunitetit dhe civilizimit të shoqërisë, kontribuojnë direkt në cilësinë e programit.

b. Pika të dobëta:

- 1) Nga analiza e syllabuseve rezulton se mosrealizim të të gjitha kompetencave, duket se programi ka një fokusim më të madh në nivelin e studimit dhe vlerësimit dhe analizës së zhvillimit të komunitetit, por me një mungesë të dukshme në kompetenca punës direkte me komunitetin, ato të menaxhimit të programeve të zhvillimit komunitar.
- 2) Në dokumentacionin e studentëve vihet re mungesa në dy raste e CV-ve dhe dëshmisë së gjuhës së huaj.

c. Mundësitë:

- 1) Interesi për fushën studimore dhe specialitetin në trend zhvillimi.
- 2) Motivimi dhe kënaqësia e studentëve me programin rezulton të jetë i lartë.

d. Pengesat:

- 1) Numri shumë i vogël i studentëve.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

1. Dr. Eliona Kulluri Bimbashi